



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
PRIVREDNI SUD KOSOVA – COMMERCIAL COURT OF KOSOVO

AD/GJKK.nr.01/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Autoriteti Kompetent - Kryetari i Gjykatës Mahir Tutuli, duke vendosur sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga DARDAFON.net L.L.C me seli në Fushë Kosovë, ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë F.B., bazuar në dispozitën e nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 22.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e ushtruar nga DARDAFON.net L.L.C, ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komerciale – F.B., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate, më 31.02.2024, përmes një shkrese zyrtare ka pranuar nga M.GJ. – në cilësinë e drejtorit në Dardafon.net L.L.C, ankesë për inicimin e procedurës disiplinore kundër gjyqtarit të Dhomave të Shkallës së Dytë – F.B., me pretendimin për shkelje disiplinore, shkelje thelbësore procedurale, dhe arsyeve të tjera subjektive.

Parashtruesi i ankesës në cilësi të drejtorit të kreditorit, në ankesën për inicim të procedurës disiplinore pretendon se gjyqtari F.B., nuk ka mbajtur seancë dëgjimore për shqyrtimin e drejtpërdrejtë të çështjes, sipas Nenit 190 paragrafi 3 të LPK-së, në bazë të së cilit gjyqtari ka qenë

i detyruar të hap shqyrtim të çështjes, duke pasur parasysh që paraprakisht shkalla e dytë gjyqësore i ka prishur për herë të tretë Aktvendimet e Shkallës së Parë të evidentuara si: KPPP.nr.365/23; KPPP.nr.1486/19 dhe KPPP.nr.1996/22. Këto Aktvendime sipas pretendimeve në ankesë janë prishur mbi bazën e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, ngase bazuar në dispozitën e nenit 190 paragrafi 3 të LPK-së gjyqtari ka qenë i obliguar që të mbajë shqyrtim gjyqësor të kësaj çështje.

Kryetari i Gjykatës pas pranimit të ankesës, më datë 12.02.2024 bazuar me nenin 9 paragrafi 5 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Nr. 05/L-057, ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, lidhur me ankesën me shkrim për Përgjegjësi Disiplinore për gjyqtarin F.B..

Bazuar në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kryetari i gjykatës më 05.02.2024, ka kërkuar nga gjyqtari F.B. deklaratë me shkrim lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore.

Më 06.02.2024, gjyqtari F.B. në deklaratën e tij të dhënë me shkrim, lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën për iniciimin e procedurës disiplinore, ka thënë se aktvendimi KDHSII.nr.1128/23 (i gjykatës së shkallës së dytë), për prishjen e Aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, është marrë në tërësi në pajtim me Ligjin për Procedurën Përmbartimore dhe Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe nuk është shkelur asnjë dispozitë e vetme në ligjet e lartë theksuara, ndërsa arsyet e vendimmarrjes janë elaboruar dhe arsyetuar në detaje në këtë aktvendim. Sipas tij pretendimet e kreditorit në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, janë të pa bazuara si dhe nuk janë të mbështetura ligjërisht, janë deklarative me qëllim denigrimi të pozitës së gjyqtarit, e me tendencë për të ndikuar në vendimmarrje.

Gjithashtu thekson se duke u bazuar nga këto që u thanë më lartë, pasi që kreditori dyshon në paanësinë e tij lidhur me vendosjen e kësaj çështje, e me asnjë fakt nuk ka provuar se një gjë e tillë ekziston, por sidoqoftë i propozon kryetarit të Gjykatës, që pasi që të shqyrton kërkesën për iniciim të procedurës disiplinore dhe këtë deklaratë, të vlerëson se a ka vend për iniciim të procedurës disiplinore ngase në Nenin 107, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e

paraparë se “Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre si gjyqtarë” dhe më pastaj të vendosë për inicim të procedurës disiplinore, gjithnjë duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm për rritjen e besimit të qytetarëve se gjykatat janë objektive dhe të paanshme në gjykimin e çështjeve gjyqësore.

Kryetari i Gjykatës Komerciale, si autoritet kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe vendosjen e tyre, pasi shqyrtoi ankesën/kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore me pretendimet si më lartë, deklaratën e gjyqtarit dhe shkresat e lëndës përmes të cilave pretendohet se gjyqtari ka bërë shkelje të ligjit dhe dispozitave ligjore, gjeti se kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore **është e pabazuar**.

“Autoriteti Kompetent sipas nenit 9 paragrafi 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 paragrafi 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore ose është parashkruar...” – neni 9 paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti i gjykatës vlerëson se në kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore, pretendimet e paraqitura, janë pretendime të natyrës së shkeljeve procedurale të cilat mund të atakohen në procedura gjyqësore, por të njëjtat nuk përbejnë shkelje disiplinore, të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

Për më tepër ky proces i natyrës disiplinore për gjyqtarin F.B., ka përfunduar me aktvendimin KDHSII.nr.1128/23 të datë 30.11.2023, me të cilin vendim është aprovuar ankesa e debitorit dhe çështja përmbartimore është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Dhomat e Shkallës së Parë, rrjedhimisht edhe sipas Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve, në bazë të të cilit është kërkuar inicimi i procedurës disiplinore, nuk përcaktohet ekzistenca e inicimit të procedurës disiplinore kundër gjyqtarit pa u atribuar të gjitha faktet si shkelje disiplinore.

Rrjedhimisht, nuk mund të konstatohet se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore apo të ketë vendosur kundërligjshëm, dhe nuk mund të konkludohet se gjyqtari ka bërë shkelje gjatë trajtimit të rastit, andaj ankesa e paraqitur nuk përmban elementet e përcaktuara dhe informata bindëse se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

AD.GJKK.nr.01 /2024, më datë 22.02.2024

Mahir Tutuli

Kryetar i Gjykatës Komerciale